

Konferenca Ministrore 2025

Reformat për raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë: orientimi mes agjendës së gjelbër dhe agjendës digjitale

18 Mars 2025, Vjenë, Austri



REFORMAT PËR RAPORTIMIN FINANCIAR DHE RAPORTIMIN E QËNDRUESHMËRISË: ORIENTIMI MES AGJENDËS SË GJELBËR DHE AGJENDËS DIGJITALE

18 Mars 2025 • Hotel “Imperial Riding School”, Vjenë, Austri

Konferenca ministrore “Reformat për raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë: orientimi mes agjendës së gjelbër dhe agjendës digjitale” organizohet nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar dhe Qëndrueshmërisë (CFRR) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Austrisë.

Konferenca ka për objektiv ndërgjegjësimin dhe mobilizimin e mbështetjes politike për reformat e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ). Synimi është të përmirësohet vendimmarrja, llogaridhënia, transparencja dhe arritja e objektivave të zhvillimit. Gjatë aktivitetit do të shqyrtohen tendencat e lidhura me klimën që ndikojnë te kontabilistët dhe audituesit dhe do të evidentohen përparimet e fundit në digjitalizim, që mund të ndihmojnë për të pasur informacion financiar dhe jofinanciar të besueshëm dhe transparent në sektorin publik dhe atë privat.

Kjo vjen në një moment kritik, kur autoritetet kombëtare janë duke analizuar rrjedhojat e standardeve të reja të raportimit të qëndrueshmërisë për sektorin privat dhe publik dhe mënyrën më të mirë për t'u përgjigjur. Kjo paraqet vështirësi shtesë, duke qenë se shumë qeveri të rajonit nuk e kanë përfunduar ende kalimin në kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe kanë përparim të kufizuar në konsolidimin e informacionit financiar për të gjithë sektorin publik.

Teknologjitë digjitale do të ndihmojnë raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë, por lypset punë e mëtejshme për të forcuar qeverisjen e të dhënave dhe për të zhvilluar kapacitetin e personelit dhe mjetet analitike të përshtatshme për palët e interesit të sektorit privat dhe atij publik. Vënia në zbatim e raportimit të qëndrueshmërisë do të kërkojë angazhim politik të nivelit të lartë për reformën rregullatore dhe investime të konsiderueshme për rritjen e kapaciteteve të rregullatorëve, ndërmarrjeve publike, private dhe shtetërore, gjë që Konferenca synon të nxisë.

Priten mbi 250 delegatë të nivelit të lartë, përfshirë ministra të financave nga vendet partnere, zyrtarë të lartë shtetërorë, partnerë ndërkombëtarë për zhvillim, përfaqësues të lartë të sektorit publik dhe privat, të bashkësive profesionale dhe akademike dhe ekspertë të institucioneve kryesore ndërkombëtare dhe të BE-së.

Konferenca u jep mundësi pjesëmarrësve të diskutojnë me ekspertë ndërkombëtarë dhe kolegë nga rajoni mbi temat dhe vështirësitë kryesore të lidhura me qëndrueshmërinë dhe raportimin financiar si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, transformimin digjital, përdorimin e inteligjencës artificiale dhe si mund të ndikojnë këto në profesionin kontabël.

Konferenca ministrore do të shoqërohet me aktivitete të tjera për profesionistët dhe zyrtarët e lartë, për të plotësuar dhe zgjeruar më tej temat e saj:

- 17 mars - Forumi për çuarjen përpara të reformës së kontabilitetit dhe auditimit
- 17 mars - Seminar mbi masat e ndërmarrjeve shtetërore për ndryshimet klimatike
- 17 mars - Forumi IX ekzekutiv mbi SNRF-të për rregullatorët - përditësim mbi SNRF-të dhe qëndrueshmërinë
- 19 mars - Seminar mbi raportimin e qëndrueshmërisë

Gjuha e konferencës është anglishtja me përkthim simultan në shqip, boshnjakisht/kroatisht/serbisht dhe rusisht.

Konferenca ministrore financohet nga tre programe të zbatuara nga Qendra CFRR: Programi për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik (PULSAR); Rruga drejt Evropës: Programi për Reformën e Kontabilitetit dhe Fuqizimin Institucional për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (REPARIS për NVM-të) dhe Programi i Përmirësimit të Kontabilitetit, Auditimit dhe Raportimit të Qëndrueshmërisë (EAASURE). CFRR mbështet në vendet pjesëmarrëse reformën e raportimit në sektorin publik, sektorin privat dhe sektorin e ndërmarrjeve shtetërore.

Vendet pjesëmarrëse në programet e CFRR-së: Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Serbia, Shqipëria dhe Ukraina.

PROGRAMI

08:30 — Regjistrimi dhe kafeja e mirëseardhjes

09:00 — Prezantimi i aktivitetit

Në këtë seancë do të jepen shpjegimet përkatëse dhe do të prezantohet raundi i parë i folësve.

Folës

Iwona Warzecha

Specialiste e lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

09:05 — Fjala e mirëseardhjes

Mesazhet më kryesore:

- Qëndrueshmëria është kryefjala për sfidën e zhvillimit dhe për misionin e Bankës Botërore.
- Standardet e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë do të sjellin ndryshime në praktikën e raportimit në mbarë sektorin publik dhe atë privat.
- Qendra për Reformën e Raportimit Financiar dhe të Qëndrueshmërisë mbështet strategjitë e vendeve për reformat e raportimit në sektorin publik, sektorin privat dhe sektorin e ndërmarrjeve shtetërore në mbarë EAQ-në, falë mbështetjes bujare nga BE-ja, Austria dhe Zvicra.

Folësit

Antonella Bassani

Nënpresidente, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, Grupi i Bankës Botërore

Harald Waiglein

Drejtor i Përgjithshëm për Politikën Ekonomike dhe Tregjet Financiare, Ministria e Financave, Austri

Folës

Manuel Irman

Zëvendësambasador, Ambasada e Konfederatës Zvicerane në Austri

09:25

Fjalimi kryesor: Politika e Gjelbër e BE-së për sektorin e shoqërive private

Objektivi: nxitja e përdorimit të standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë nga shoqëritë tregtare private, nxjerrja e mësimave nga viti i parë i zbatimit të SERQ-së dhe nga zhvillimet e fundit në BE dhe më gjerë, shqyrtimi i tendencave të politikave dhe raportimit të qëndrueshmërisë.

Mesazhet më kryesore:

- BE-ja ka vënë në zbatim standardet më të mira botërore të raportimit të qëndrueshmërisë dhe të zinxhirit të furnizimit dhe taksa importi të lidhura me klimën – çka ka ndikuar te bizneset të cilat bëjnë tregti me Bashkimin Evropian.
- Raportimi i qëndrueshmërisë në sektorin privat dhe publik është një shtysë për bizneset dhe për qeveritë për të arritur qëllimet e tyre mjedisore dhe detyrimet ndërkombëtare.
- Rekomandohet që biznesi të përqendrohet te ndikimi me rëndësi materiale në qëndrueshmërinë.
- Raportimi i qëndrueshmërisë duhet të mbështetet me të dhëna dhe të jetë sa më i automatizuar.
- Dhënia efektive e sigurisë është me shumë rëndësi për të shmangur fasadën e rreme ekologjike.
- Po mësojmë në punë e sipër – BE-ja kërkon tashmë të reformojë disa legjislacione kyçe.
- Nxiten rregullatorët të marrin në konsideratë nevojat dhe aftësitë e subjekteve të sektorit privat dhe të mbështesin dhe të bëjnë legjislacionin e nevojshëm.

Folës

Paul Gisby

Drejtor i Lartë, Accountancy Europe

09:45

Panel ministror: përballimi i sfidave dhe mundësive të reformës së raportimit financiar dhe raportimit të qëndrueshmërisë

Objektivi: shprehja e angazhimit për reformën e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë, si dhe evidentimi i prioritetëve, mundësive dhe sfidave në kontekstin e vendeve.

Mesazhet më kryesore:

- Raportimi cilësor financiar dhe i qëndrueshmërisë ka rëndësi jetike për investimet (përfshirë financat e gjelbra), tregtinë dhe rritjen e qëndrueshme.
- Shprehja e angazhimit për zbatimin e kornizave të raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë së vendeve në përputhje me standardet ndërkombëtare ose të BE-së.
- Qeveritë mund të ndjekin një qasje me faza për të ndihmuar dhe ulur koston e futjes në zbatim të raportimit të qëndrueshmërisë.
- Qeveritë mund të mbështesin zhvillimin e kapaciteteve teknike për vënien në zbatim të raportimit të qëndrueshmërisë.
- Qeveritë do të duhet ta kanalizojnë mbështetjen e Bankës Botërore dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë drejt zbatimit të reformave.

Folës në panel

Victoria Belous

Ministre e Financave, Republika e Moldavisë

Novica Vuković

Ministër i Financave, Mali i Zi

Arman Poghosyan

Zëvendësministër, Ministria e Financave, Armeni

Svitlana Vorobey

Zëvendësministre, Ministria e Financave, Ukrainë

Drejtuese

Xiaoqing Yu

Drejtoreshë Rajonale, Njësia e Menaxhimit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, Banka Botërore

10:45

Pushim për kafe – mundësi për njohje

11:15

Raportimi i qëndrueshmërisë në sektorin publik dhe atë privat

Objektivi: të dëshmohet se si rregullatorët, profesioni kontabël dhe bizneset mund të vënë në jetë me sukses raportimin e qëndrueshmërisë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Mesazhet më kryesore:

- Rregullatorët do të duhet t'u japin orientime bizneseve se si të vënë në zbatim raportimin e qëndrueshmërisë.
- Qeveritë dhe organet e profesionit do të duhet të japin mbështetje për vënien në zbatim dhe të sigurojnë instrumentet e duhura.
- Qeveritë mund të mbështeten në përvojën ndërkombëtare.
- Qëndrueshmëria të integrohet në strategjitë e shoqërive tregtare si një udhëzues për të gjithë vendimmarrjen.
- Kostoja e moszbatimit do të jetë më e lartë se kostoja e raportimit.
- Universitetet dhe organet e profesionit kontabël duhet të jenë një hap para, duke e integruar raportimin e qëndrueshmërisë në programet mësimore.
- Fasada e rreme ekologjike dhe sjellja joetike e cenojnë besueshmërinë e bizneseve në ekonomi.

Folës në panel

Saskia Slomp

Drejtoreshë, EFRAG

Gernot Netinger

Drejtor, Drejtorja e Financave Private, ÖBB, Grupi Hekurudhor Austriak, ÖBB-Holding AG, Austri

Lee White

Drejtor, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC)

Folës në panel

Dritan Fino

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme për Menaxhimin e Fondeve të Bashkimit Evropian në Ministrinë e Financave, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Shqipëri

Drejtues

Arturo Herrera Gutierrez

Drejtor, Departamenti Global i Institucioneve, Banka Botërore

12:45

Pushimi i drekës

14:00

Inteligjenca Artificiale – rreziku dhe mundësitë për kontabilitetin dhe auditimin

Objektivi: nxitja e përdorimit të IA-së në kontabilitet, auditim dhe raportimin e qëndrueshmërisë për sektorin publik dhe privat.

Mesazhet më kryesore:

- Mos kini frikë, përqafojeni IA-në dhe administroni rreziqet.
- Rregullorja e re e BE-së për zbatim të sigurt të IA-së mund të sigurojë një kornizë të përshtatshme për vendet e tjera të EAQ-së.
- IA rrit rendimentin e kontabilitetit dhe auditimit - mësimet e para të nxjerra nga sektori.
- Të sigurohet një përdorim gjithëpërfshirës për të mbështetur praktikat vogla dhe të mesme të auditimit.

Folësit

Eleonora Laurenza

As. Prof. e Inteligjencës Artificiale, Fakulteti i Informatikës, UT Vjenë; Përgjegjëse Novacioni, Banka Qendrore e Italisë

Sandro Fuchs

Profesor për Menaxhimin e Financave Publike, Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Zyrihut, Zvicër

Drejtues

João Ricardo Vasconcelos

Specialist i lartë i qeverisjes, GovTech & Novacioni në Sektorin Publik – Departamenti Global i Institucioneve, Banka Botërore

15:15 — Pushim për kafe

15:45

Raportimi i qëndrueshmërisë dhe masat e ndërmarrjeve shtetërore për klimën

Objektivi: promovimi i rolit të NSH-ve si subjekte me rolin udhëheqës në raportimin e qëndrueshmërisë dhe veprimin për klimën.

Mesazhet më kryesore:

- NSH-të kanë rëndësi jetike për objektivat shtetërore të përshtatjes dhe zbutjes së efekteve klimatike.
- Aksionarët, investitorët dhe mbajtësit e obligacioneve kërkojnë informacione cilësore mbi rreziqet dhe ndikimin në qëndrueshmëri.
- Standardet ndërkombëtare dhe evropiane të raportimit të qëndrueshmërisë ofrojnë një kuadër të besueshëm për raportimin e integruar financiar dhe të qëndrueshmërisë.
- Qëndrueshmëria duhet të integrohet në politikat e pronësisë, drejtimin e brendshëm dhe strategjitë e NSH-ve.

Folës në panel

Minas Trubljanin

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria për Harmonizimin Qendror dhe Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm, Ministria e Financave, Mali i Zi

Emmeline Stein

Zëvendëssekretare e Përgjithshme, Agence des Participations de l'État (APE), Francë

Ida Krabek

Drejtor i Qëndrueshmërisë Globale, Global Sustainability Commercial, Ørsted, Danimarkë

Folës në panel

Christopher Sheldon

Drejtor, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mali i Zi, Banka Botërore

Drejtues

Fabian Seiderer

Menaxher, Institucionet, Evropa dhe Azia Qendrore, Banka Botërore

17:00

Fjala mbyllëse

Folës

Arturo Herrera Gutierrez

Drejtor, Departamenti Global i Institucioneve, Banka Botërore

17:15 — Fundi i konferencës

17:30 — Pritje-koktej

18:30 — Fundi i pritjes-koktej

Programet e CFRR-së finanohen nga



European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

 Austrian
Development
Cooperation